



Shkollë Verore në Montpellier të Francës

■ **Shkolla** ndodhet në Montpellier, qytet bregdetar në Jug të Francës me klimë mesdhetare dhe me qiell të kaltër që e shoqëron gjatë gjithë vitit. Nga ana arkitekturore është një vend i mrekullueshëm, me hapësira të gjera, sheshe, shatërvane, dhe ndërtesa madhështore, të gjitha të ndërtuara me një stil neo-klasik modern të dallueshëm. "Mësimi i Gjuhës Frënge për Fëmijë" është një formulë, që e ofron vetëm kjo shkollë. Profesorët e saj, të cilët njihen për përvojën e madhe dhe entuziazmin në mësimdhënie, do t'i ndihmojnë studentët të përfitojnë maksimumin gjatë qëndrimit në shkollë. Kujdes i kushtohet përmirësimit të aftësisë së të folurit dhe dëgjimit përmes aktiviteteve kulturore.

■ **Rezidencë Shkolle:** Fëmijët e moshave 14 vjeç e sipër kanë mundësi të qëndrojnë në rezidencën e studentëve, që ndodhet vetëm 10 min larg nga shkolla. Këtu ofrohen dhoma teke ose të përbashkëta, secila e pajisur me telefon, internet, një kuzhinë të vogël, banjo, frigorifer, mikrovalë, ambjent gatimi, tavolinë studimi, raft rrobash. Në katin e parë ka distributor pijesh, lavanderi dhe jashtë një verandë me tavolina dhe karrige. Vaktet ofrohen në sallën e ngrënies së shkollës. Në fundjavë e ditë eskursionit serviret ushqim i paetuar.

■ **Qëndrimi në familje mikpritëse** është mënyra më e mirë për të përmirësuar frëngjishten. Do të qëndroni në dhoma dyshe dhe familja do të pëkujdeset për ju. Në ditët e ekskursioneve gjatë fundjavës, do të pajiseni me ushqim të pakëtuar.

■ **Programet sociale ofrojnë:** sporte të ndryshme, vizita në muze, role në shfaqje, diskutime, video, këngë, udhëtime, lojra, barbecue dhe ekskursione, duke mos harruar plazhet e mrekullueshme ranore të Palavas-les-Flots, La Grande Mottte dhe Carnon-Plage.



Çmimi përfshin:

- **Leksionet e gjuhës frënge**
- **Akomodimin** në familje / rezidencë shkolle
- **Vaktet** (sipas zgjedhjes)
- **Aktivitetet** e ndryshme, eskursionet
- **Internet falas** me salla kompjuteri moderne
- **Mbikqyrje** e garantuar nga stafi i shkollës

Tarifa të tjera

Aeroport – Montpellier	65€
Montpellier – Aeroport	95€
Tarifë Administrative JDJ Albania:	50€
Biletë Udhëtimi	
Tarifë Vize	
Sigurim jete në udhëtim	

Shkollë Verore Gjuhe Frëngjisht

Mosha:	14 - 17 vjeç
Kohëzgjatja:	Min. 1 javë
Periudhat e zhvillimit të kurseve:	27.06.2010 – 28.08.2010
Regjistrimi:	Çdo javë
Niveli:	Të gjitha
Nr. i pjesëmarrësve	16 studentë maks.
Lloji i kursit:	Intensiv
Nr. i leksioneve:	20 leks. (nga 45 min.)
Akomodimi:	Familje mikpritëse
Çmimi: (mëngjesi dhe darka)	600 €
Çmimi: (vakte të plota)	640 €
Akomodimi:	Rezidencë e shkollës
Çmimi: (mëngjesi dhe darka)	620 €
Çmimi: (vakte të plota)	650 €